



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 400, datë 07.10.2020

PËR

SHPALLJEN E KËRKESËS PËR KANDIDATURA NGA RADHËT E GJYQTARËVE PËR KOMANDIM NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR, KOHËZGJATJEN, KRITERET DHE PROCEDURËN E KOMANDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 79, shkronja “b”, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me bashkë propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës dhe Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

I. Shpallja e kërkesës për kandidatura

1. Shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor për një pozicion “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor.
2. Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është 5 (pesë) ditë nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente:
 - a. Kërkesë me shkrim për shfaqjen e vullnetit për komandim për pozicionin ku do të komandohet;
 - b. Jetëshkrimin, ku kandidati pasqyron, veç të tjerash, çdo të dhënë në lidhje me kriteret e komandimit, përveç edhe të dhënat mbi historikun e arsimimit dhe rezultatet e tij;
 - c. Certifikatë/dëshmi për gjuhën e huaj;
 - d. Pesë dokumente ligjore, vendime gjyqësore, artikuj apo botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës, etj ;
 - e. Çdo dokument tjetër që tregon plotësimin nga kandidati të kriterëve të komandimit.

II. Kohëzgjatja, kriteret dhe procedura e komandimit

1. Kohëzgjatja e komandimit është 2 (dy) vjet.

2. Komandimi mund të përsëritet edhe për një kohëzgjatje tjetër deri në 3 (tre) vjet.
3. Kohëzgjatja e komandimit mund të përfundojë para afatit:
 - a. me kërkesë të gjyqtarit, për shkaqe të justifikuara;
 - b. kur vazhdimi i komandimit bie ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku i komanduari ushtron funksionin e gjyqtarit.
4. Kriteret e komandimit janë:
 - a. Kandidati të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë si gjyqtar ;
 - b. Komandimi të mos bjerë ndesh me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin e gjyqtarit;
 - c. Kandidati të mos jetë në një pozicion me mandat të kufizuar;
 - d. Kandidati të mos jetë i komanduar;
 - e. Kandidati, që ka qenë i komanduar më parë, të ketë shërbyer jo më pak se 5 (pesë) vjet si gjyqtar pas përfundimit të periudhës së mëparshme të komandimit;
 - f. Kandidati të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
5. Ka përparësi kandidati që plotëson këto kriteret:
 - a. Ka ekspertizë të veçantë në fushën e hartimit të akteve rregullatore;
 - b. Ka njohuri mbi legjislacione të vendeve të Bashkimit Evropian, mbi akte ndërkombëtare dhe mbi jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, në lidhje me statusin e gjyqtarit dhe organizimin e sistemit gjyqësor;
 - c. Është autor i artikujve ose botimeve shkencore në fushën e jurisprudencës;
 - d. Ka njohuri të mira të paktën në një gjuhë të vendeve të Bashkimit Evropian;
 - e. Ka aftësi të mira profesionale, organizative, personale, si dhe etikë të lartë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale.
6. Për vlerësimin e kriterëve të kandidimit, Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetet në dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, në dokumentacionin e administruar nga Këshilli, në dokumentacionin e dosjes personale të kandidatit, si dhe në çdo dokument tjetër që mund të merret nga burimet e përcaktuara në nenin 77 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
7. Brenda dy javëve pas afatit të aplikimit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku kandidati ushtron funksionin. Projekt-opinionin për çdo kandidat shqyrtohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor jo më vonë se një javë pas njoftimit të Kryetarit të Këshillit për përgatitjen e tyre. Opinionet e miratuara nga Këshilli publikohen në faqen zyrtare të tij. Këshilli vendos përjashtimin nga komandimi të kandidatit, komandimi i të cilit nuk është në përputhje me interesat e lartë të gjykatës ku ai ushtron funksionin apo kur për kandidatin verifikohet ndonjë prej kriterëve të tjera ndaluese të komandimit.
8. Procedura e komandimit vijon me vlerësimin e kriterëve të kandidimit për të gjithë kandidatët që nuk janë përjashtuar nga kandidimi sipas pikës 7 të këtij Kreu. Ky vlerësim bëhet nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i cili, kur çmon të nevojshme, mund të intervistojë kandidatin për verifikimin e kriterëve të kandidimit. Intervista dokumentohet në një procesverbal me shkrim.

9. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale brenda dy javëve i paraqet Këshillit të Lartë Gjyqësor një raport ku pasqyrohen të dhënat rreth përmbushjes nga kandidatët të kriterëve të kandidimit, përveç edhe një renditje të tyre duke filluar nga kandidati i vlerësuar më mirë. Krahas kësaj, Komisioni i paraqet Këshillit dhe një propozim për komandim me emrin e kandidatit të renditur më lart.
10. Brenda një jave nga paraqitja e raportit dhe propozimit për komandim, Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor thërret mbledhjen plenare, për të vendosur në lidhje me komandimin e gjyqtarit kandidat në pozicionin e mësipërm.
11. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos komandimin për kandidatin e propozuar nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale. Në rast të mosmiratimit të propozimit të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, çdo anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor mund të propozojë komandimin e një gjyqtari tjetër kandidat që plotëson kriteret e komandimit. Ky propozim i nënshtrohet votimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
12. Nëse asnjë prej gjyqtarëve kandidatë nuk komandohet, Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të rishpallë kërkesën për kandidaturë nga radhët e gjyqtarëve për plotësimin e pozicionit “nëpunës përgjegjës për vlerësim” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR